

Data 21.07.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SHËRBIM MIRËMBAJTJE PËR PAJISJET E KONDICIONIMIT”,

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e MK deri në **3 416 550** (tre milion e katërëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa Tvsh.**

Shumatorja e çmimeve për njësi deri në **309.380,0** (treqind e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë) **Lekë pa Tvsh.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45331000-6 - Punime ngrohje, ventilimi dhe kondicioneresh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Perllogaritja e fondit limit është kryer mbështetur në nenet 12 dhe 13 të VKM nr 285 date 19.05.2021, neneve 59-63, nenit 64 “*Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër*”, në Udhezimin nr 30 date 27.12.2021 ” Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e prokurimit publik”, të ndryshuar Kapitulli II , pika 23, mbi bazën e studimit të tregut nga struktura e ngritur nga AK për këtë qëllim, duke iu drejtuar disa operatoreve ekonomike në treg që operojnë në fushën e këtij objekti prokurimi, pasi nuk ekzistojnë çmime reference zyrtare për këto lloj shërbimesh.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

-Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të shoqërisë e vlefshme me kategorinë:

NS12-A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

NS14-A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",

Argumentimi i AK: *Konsideruar natyrën e shërbimeve objekt kontrate , licensat e siperkerkuara jane referenca cilesore profesionale prioritare per AK qe Oe ofertues duhet te zoteroje per te kryer sherbime cilesore . AK i është referuar për këtë qëllim në evidentimin e tyre edhe VKM Nr. 943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim"*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues te vertetoje qe :

Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit prej 3 (tre) vjetëve të fundit financiare të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit.

Argumentimi Ligjor: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43 pika 2/c dhe pika 3 VKM 285 dt 19.05.2021 te ndryshuar*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK: *Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Argumentimi i AK: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091, datë 05.03.200.

2.2.3 OE të oaraqes nje dokument që vërteton se i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatoriekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij , (Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB).

Argumentimi ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Argumentimi i AK:Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3.4 (Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate tre viteve te fundit **nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates** në vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

(Referuar nenit 55 pika 4/b te VKM 285 dt 19.05.2021 te ndryshuar)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontraten, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontraten e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe ”Njoftimit për sqarim” nr 3872/1 date 29.06.2021 të APP.”

Argumentimi i AK Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të shërbimeve ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te ketë minimalisht te punësuar e siguruar sipas legjislacionit te kodit të punës në fuqi, 8 punonjs, prej të cilëve:

-1 (nje) Inxhinier Mekanik (Drejtues Teknik të identifikuar në Licensën e kompanisë),

për të cilin operatori duhet të paraqesë:

- a) Diplomën
- b) Kontratën Individuale të punës

-1(një) Inxhinier elektrik per te cilin operatori ekonomik të paraqese:

- a) diplomën
- b) kontratën individuale të punës.

-1 (një) inxhinier i pajisur me certifikatë per Auditimin e Energjisë lëshuar nga një institucion i akredituar në Shqipëri.

Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë sipas legjislacionit ne fuqi **per tre muajt e fundit** punonjesit e meposhtem sipas kodeve te punes,

- 2 (dy) punonjës specialist ngrohje ftohje/kondicionimi të pajisur edhe më deshmitë përkatëse të kualifikimit e sigurimit teknik.

- 1(një) punonjës elektromekanik i pajisur edhe me deshmitë përkatëse të kualifikimit e sigurimit teknik.

- 2 (dy) punonjës elektrikist të pajisur edhe me deshmitë përkatëse të kualifikimit e sigurimit teknik.

- 1(një) punonjës saldator i pajisur edhe me deshmitë përkatëse të kualifikimit e sigurimit teknik.

Argumentimi ligjor : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, numri i punonjesve te kerkuar, ne baze te kerkeses se Autoritetit Kontraktor, per realizimin e objektit është mëse i justifikueshem dhe cilësisht parësor për volumin, shpërndarjen gjeografike dhe natyren e shërbimeve objekt kontrate .

2.3.3 Në zbatim te Ligjit Nr. 10237, date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shëndetin në punë” Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certificate formimi dhe trajnimi për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Argumentimi ligjor : Neni 44 pika 1,2,3,4 te VKM të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar

Argumentimi i AK: Kerkesat e pikes 2.3.3 tashme certifikata gjeresisht te kerkuara ne fushen e prokurimeve ne respektim te standarteve, te sigurise në punë.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të deshmojë se ka në pronësi ose me qira mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Automjete ATP	- 1(një) Copë
Motocikletë (për raste emergjente)	-1(një) Copë
Trapano dore	-1(një) Copë
Saldatrice	-1(një) Copë

-Në rast se mjete është në pronësi OE duhet të paraqesë:

– Faturë blerje,

- Certifikatë pronësie,
- Leje qarkullimi, siguracion, akt kolaudim, taksa vjetore.
- Në rast se mjetet janë me qera, operatori ekonomik duhet të paraqese
- kontratë qiraje noteriale,
- certifikatë pronësie të qiradhënësi,
- Leje qarkullimi, siguracion, akt kolaudimi, taksa vjetore.

Argumentimi ligjor : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Argumentimi i AK : Objektet e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike kanë shpërnadrje në distancë nga njëri-tjetri në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe shkak të shtrirjes në distanca, si dhe shumica e tyre si çerdhe, Kopshte dhe shkolla janë në zona ku ka trafik gjatë gjithë orarit të kërkuar për ndërhyrje riparimi dhe shërbimi teknik (07:00 deri 17:00). Mjeti motocikletë ndihmon specialistin të arrijë në destinacion në orarin e kërkuar. Trapano dore dhe saldatriçe janë mjete pune të domosdoshme dhe minimaliste në funksion të operacioneve mirembajtëse .

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme (të vlefshme) objekti i të cilave të jetë në përputhje me objektin e prokurimit:

- Certifikatë **ISO 50001-2011** të vlefshme ose *ekuivalente*, lidhur me sistemin e menaxhimit të energjisë e cila të përfshijë objektin e prokurimit. Certifikata duhet të jete e lëshuar nga organismat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma kombëtare akreditues.
- Certifikatë **ISO 27001:2013** të vlefshme ose *ekuivalente*, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma kombëtare akreditues.
- Certifikatë me **ISO 41001:2018** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të objekteve, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe i noterizuar).

Argumentimi ligjor : Në bazë të Neni 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, pika 5. Për të

provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; si dhe në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore".

Argumentimi i AK : Kërkesat e pikës 2.3.5 janë certifikata kualitative, tashmë gjërësisht të kërkuara në fushën e prokurimeve në respektim të standarteve, të cilesisë në punë dhe përdorimit me efikasitet të energjive të çdo lloji, në respektim të standardeve me impakt të ndjeshëm ambiental etj..

Për më tepër siguria e informacionit është thelbësore pasi aksesohet në ambiente serverash të institucione të administratës vendore me infrastrukturën IT të institucioneve për efekte monitorimi menaxhimi të temperaturës dhe jo vetëm.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje janë të certifikuara (CE).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues të paraqesë vetëdeklarata për marrjen përsipër dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes të sistemeve të ngrohje-ftohjes sipas listës së specifikimeve teknike në çdo orë dhe ditë të kohëzgjatjes sipas kushteve të kontratës.

Argumentimi: AK synon një sipërmarrje të garantuar për këto shërbime me përdorimin e materialeve dhe pjesëve të ndërrimit të standardeve CE, si dhe disponibiliteti maksimal përben kriter parësor për përmbushjen e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi ligjor: Parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Argumentimi i AK: Gjate hartimit të specifikimeve teknike dhe termave të referencës AK i është referuar VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre", ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018, katalogjet shoqëruese të pajisjeve që do të mirëmbahen, eksperiencave për këtë tipologji shërbimesh në institucion dhe eksperiencës së specialistit të fushës.

AK në asnjë rast nuk ka përdorur emra markash/standartesh dhe në çdo rast standardet apo kërkesat e performancës janë shoqëruar me fjalët "ose ekuivalent".